

Njoftim për shorteun publik të datës 12.03.2024 me objekt shpërndarjen / caktimin, midis përfituesve nga procesi i rindërtimit, i banesës kolektive nr.30 Rruga “Hysen Myshketa”, Njësia Administrative nr.3, Durrës .

Në mbështetje të Ligjit 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, Aktit Normativ nr. 9, datë 16.12.2019 të Këshillit të Ministrave, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 592, datë 13.10.2021 Për disa shtesa në vendimin nr. 904, datë 24.12.2019, të Këshillit të Ministrave, “Përcaktimin e rregullave, të kategorive prioritare, masës së përfitimit, autoriteteve përgjegjëse dhe procedurave për vlerësimin dhe përzgjedhjen e përfituesve nga disa programe të procesit të rindërtimit”, të ndryshuar, Vendimit të Këshillit Bashkiak Durrës nr. 138, datë 28.10.2021, “Për miratimin e Rregullores për procedurat e zhvillimit të shorteut manual në bashkinë Durrës në kuadër të rindërtimit”,

Bashkia e Durrësit njofton përfituesit nga programi i rindërtimit se shorteu publik me objekt shpërndarjen / caktimin, midis përfituesve nga procesi i rindërtimit, i banesës kolektive nr.30 Rruga “Hysen Myshketa”, Njësia Administrative nr.3, Durrës do të zhvillohet më datë 12.03.2024 në sallën e Këshillit Bashkiak Durrës, pranë Bashkisë Durrës, kati II duke filluar nga ora 10:00.

Nëpërmjet këtij njoftimi thirren të gjithë përfituesit sipas listës bashkëlidhur.

Mosparaqitja në këtë shorte e personave përfitues i heq të drejtën e ankimit apo pretendimeve lidhur me rezultatet e këtij shorteu publik.

Personat përfitues në pamundësi për të qenë pjesmarrës në këtë shorte publik mund të përfaqësohen me prokurë. Në këto raste zbatohen dispozitat ligjore të përfaqësimit.

Nr.	PRONARI	STRUKTURA E APARTAMENTIT QË DO PËRFITOHET
1	PËLLUMB SKËNDAJ, DRITA SKËNDAJ	2+1
2	ARJAN KITA, KOZETA KITA	3+1
3	GJYLE SERVETI	1+1
4	FATBARDHA GJOLI	2+1
5	ARBEN HOXHA	2+1